



Funded by
the European Union

PUNËSIMI I KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË SEKTORIN E ARSIMIT NË KOSOVË

EDITORIAL



Funded by
the European Union

Diskutimi Publik

“Punësimi i Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Sektorin e Arsimit në Kosovë”

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë në mesin e grupeve të cenueshme në Kosovë të cilat, gjatë procesit edukativo-arsimor, përballen me kushte më të vështira sesa komuniteti shumicë. Këto kushte kanë efekte afatgjata në rezultatet mësimore dhe zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve nga këto komunitete. Një prej faktorëve me ndikim të konsiderueshëm është numri tejet i ulët i mësimitdhënësve/eve dhe edukatorëve/eve nga radhët e vetë këtyre komuniteteve, të cilët/at kanë kualifikimet dhe përvojën e duhur për t’u përfshirë në sektorin e arsimit.

Me qëllim të avokimit për këtë aspekt të rëndësishëm të jetës së komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, më 6 dhjetor 2021 në Hotel International Prishtina u zhvillua një diskutim publik, i organizuar nga projekti **Cilësia, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja në Arsim 2021**. Ky projekt është i financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, dhe vihet në zbatim nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). Iniciativa avokuese për punësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, pjesë e Komponentës II të projektit të lartcekur, synon identifikimin e mënyrave optimale se si mund të shfrytëzohet potenciali i komuniteteve për të kontribuar në sektorin e arsimit.

Gjatë këtij diskutimi u paraqit një përmbledhje dhe analizë e politikave ekzistuese në këtë kuadër, e përgatitur nga eksperti i angazhuar nga rrjeti i projektit KRAEEYN (Rrjeti i Kosovës për Edukimin e Hershëm të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian). Aty u identifikuan sfidat kryesore me të cilat përballen profesionistët e kualifikuar dhe me përvojë nga radhët e komuniteteve në aspektin e punësimit në sektorin e arsimit - sfida që shfaqen si në aspektin ligjor, ashtu edhe në atë organizativ të fushës së arsimit.

Pjesëmarrësit në takim përfshinin përfaqësues të institucioneve të arsimit në nivel qendror dhe lokal, konkretisht nga Divizioni për Komunitete nga MASHTI, Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Kryeministrisë, dhe DKA nga qytetet e Prizrenit dhe Gjakovës. Më tej, pati përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë me komunitetet në fushën e arsimit, të cilët ndanë përvojën e tyre shumë-vjeçare në këtë fushë. Me rëndësi të veçantë ishte pjesëmarrja e deputetit të Kuvendit të Kosovës nga radhët e komunitetit rom, Erxhan Galushi, i cili mbajti fjalën hyrëse në takim. Deputeti Galushi u shpreh i kënaqur me pjesëmarrjen e tij në një diskutim të tillë publik, dhe shprehu gatishmërinë për të shtyrë përpara iniciativa të tilla avokuese në dobi të komuniteteve.

Zbatuar nga:





Funded by
the European Union

Pjesëmarrësit ranë dakord se duhet bërë më shumë për të hapur rrugën drejt punësimit më të madh të profesionistëve të kualifikuar nga radhët e komuniteteve, duke ngritur mekanizma ligjore adekuate. U sugjerua ristrukturimi i kuadrit ligjor ekzistues dhe ndryshimi i qasjes ndaj kësaj problematike, dhe shtrirja më e gjerë e pjesëmarrësve në takime të kësaj natyre duke përfshirë DKA nga qytete të tjera ku jetojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Të gjitha propozimet e shtruara gjatë këtij diskutimi publik do të shtohen si rekomandime në dokumentin e përmbledhjes së politikave, duke shërbyer si mjet avokimi për rritjen e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin e arsimit në Kosovë.

Ky editorial është hartuar nga Bora Shpuza Kasapollli në kuadër të programit “Cilësia, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja në Arsim 2021” zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë. Përmbajtja e këtij editoriali në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Zbatuar nga:

